| 3 | 17 | Gjovalin | Pjetër | Kuli | 8210 | 7/474 | 378 | Truall ndertese | 241 | 38,614.00 | 9,305,974.00 | | | | 230 | 3,731,287 | 13,037,261.00 | | | |
| 4 | 103 | Nazif | Ram | Miha | 8210 | 7/296-nd | 205.7 | Nderte se | | | | | | | 418.4 | 8758638.00 | 8,758,638.00 | | | |
| 5 | 36 | Aishe Hysen Pellumb | | Llagami(Saraçi) Saraçi Saraçi | 8210 | 7/500 | 1,946.00 | Truall | 1,249.00 | 38,614.00 | 48,228,886.00 | | | | | | 48,228,886.00 | | | |
| 6 | 35 | Aishe Hysen Pellumb | | Llagami(Saraçi) Saraçi Saraçi | 8210 | 7/493 | 803.80 | Truall | 385.00 | 38,614.00 | 14,866,390.00 | | | | | | 14,866,390.00 | | | |
| 7 | 11 | Besnik | Adem | Doçi | 8210 | 7/521 | 254.00 | truall ndertese | 254.00 | 38,614.00 | 9,807,956.00 | 167.52 | 65,000.00 | 10,888,800.00 | 48.00 | 1,370,882.00 | 22,067,638.00 | | | |
| 8 | 12 | Besnik | Adem | Doçi | 8210 | 7/522 | 230.10 | truall ndertese | 24.70 | 38,614.00 | 953,765.80 | 151.48 | 65,000.00 | 9,846,200.00 | 70.70 | 2,019,197.00 | 12,819,162.80 | | | |
| 9 | 47 | Uke Sose Elira Besnik | Idriz Syle Idriz Idriz | Çelkolaj Çelkolaj Çelkolaj Çelkolaj | 8210 | 7/44 | 300.00 | Truall | 100.70 | 38,614.00 | 3,888,429.80 | | | | | | 3,888,429.80 | | | |
| 10 | 20 | Uke | Idris | Çelkolaj | 8210 | 7/46 | 300 | Truall | 300 | 38,614.00 | 11,584,200.00 | | | | | | 11,584,200.00 | | | |
| 11 | 48 | Halil | Muj | Muja | 8210 | 7/45 | 287.60 | Truall | 12 | 38,614.00 | 463,368.00 | | | | | | 463,368.00 | | | |
| 12 | 45 | Shoqeria Railing SHPK | | | 8210 | 7/523 | 99.5 | Trual ndertese | 91 | 38,614.00 | 3,513,874.00 | 81.6 | 65000 | 5,304,000.00 | 113.40 | 6,709,873.46 | 15,527,747.46 | | | |
| 13 | 90 | Skender | | Doda | 2679 | 440/298 | 500.00 | Truall | 113 | 4,242.00 | 479,346.00 | | | | | | 479,346.00 | 8.40 | 4,242.00 | 35,632.80 |
| 14 | 115 | Kujtim | Medat | Osmani | 3866 | 315/539-ND | 404.40 | Nderte se | | | | 139.80 | 53,500.00 | 7,479,300.00 | 264.60 | 4,609,630.00 | 12,088,930.00 | | | |
| | SHUMA në total (lekë) | | | | | | | | | | | | | | | | 215,624,987.06 | | | 4,449,999.40 |

| NR | BEHËT | | | | | | | | | | | Shënime |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Të dhënat e ndryshuara dhe shtesa | | | | | | | | | | | |
| | Numri Pasurisë | Sip. Totale m2 | Lloji Pasurise | TOKË TRUALL | | | OBJEKT BANIMI | | | NDËRTESË SOC. EK | | VLERA Totale (LEKË) | |
| | | | | Sipërfaqja e shpr.(m2) | Çmimi (lekë/m2) | Vlera lekë | Sipërfaqja e shpr.(m2) | Çmimi (lekë/m2) | Vlera lekë | Sipërfaqja e shpr.(m2) | Vlera e preventivit | | |
| 1 | 10/169 | 1627 | Truall ndertese | 245.8 | 31,219.00 | 7,673,630.20 | | | | 40 | 21,689,943 | 29,363,573 | konfirmuar nga ASHK (zbritje siperfaqeje trualli prej 133.2) Nuk eshte likujduar sipas vkm 231 dt 17.04.2019 |
| 2 | 12/21 | 922 | Truall | 649.8 | 31,219.00 | 20,286,106.20 | | | | 794 | 5,618,132 | 25,904,238 | konfirmuar nga ASHK (shtese siperfaqeje trualli 102.4 m2) |
| 3 | 7/758 | 182 | Truall | 182 | 38,614.00 | 7,027,748.00 | | | | | | 7,027,748 | konfirmuar nga ASHK (zbritje siperfaqeje trualli 59 m2). Likujduar sipas VKM 231 dt 17.04.2019 |
| 4 | 7/296-nd, 7/757 | 209.4 | truall | 186.5 | 38,614.00 | 7,201,511.00 | | | | 418.40 | 8,758,638.00 | 15,960,149.00 | konfirmuar nga ASHK (shpronesim per truallin) |
| 5 | 7/549 | 1,249.00 | Truall | 916.00 | 38,614.00 | 35,370,424.00 | | | | | | 35,370,424.00 | konfirmuar nga ASHK (zbritje siperfaqeje trualli 333 m2). Likujduar sipas VKM 231 dt 17.04.2019 |
| 6 | 7/551 | 385.00 | truall | 209.00 | 38,614.00 | 8,070,326.00 | | | | | | 8,070,326.00 | konfirmuar nga ASHK (zbritje siperfaqeje trualli 176 m2). Likujduar sipas vkm 231 dt 17.04.2019 |
| 7 | 7/521 | 254.00 | truall | 164.00 | 38,614.00 | 6,332,696.00 | | | | | | 6,332,696.00 | konfirmuar nga ASHK (zbritje siperfaqeje trualli 90 m2 dhe 215.52 m2 objekti). Nuk eshte likujduar sipas vkm 231 dt 17.04.2019 |
| 8 | | | | 0.00 | | | 0.00 | | | 0.00 | | 0.00 | nuk perfshihet ne shpronesim .Nuk eshte likujduar sipas vkm 231 dt 17.04.2019 |
| 9 | 7/44 | 300 | Truall | 40.9 | 38,614.00 | 1,579,312.60 | | | | | | 1,579,312.60 | konfirmuar nga ASHK (zbritje siperfaqeje trualli 59.8 m2). Nuk eshte likujduar sipas vkm 231 dt 17.04.2019 |
| 10 | 7/46 | 300 | Truall | 207.4 | 38,614.00 | 8,008,543.60 | | | | | | 8,008,543.60 | konfirmuar nga ASHK (zbritje siperfaqeje trualli 92.6 m2). Nuk eshte likujduar sipas vkm 231 dt 17.04.2019 |
| 11 | | | | 0 | | | 0 | | | 0 | | | nuk perfshihet ne shpronesim. Nuk eshte likujduar sipas vkm 231 dt 17.04.2019 |
| 12 | 7/54 | 91.00 | Truall | 78.60 | 38,614.00 | 3,035,060.40 | 81.6 | 65000 | 5,304,000.00 | 113.40 | 6,709,873.46 | 15,048,933.86 | konfirmuar nga ASHK (zbritje siperfaqeje trualli 12.4 m2). Eshte likujduar sipas VKM 231 dt 17.04.2019 |
| 13 | 440/298 | 500.00 | Truall | 370.40 | 4,242.00 | 1,571,236.80 | | | | | | 1,571,236.80 | konfirmuar nga ASHK (shtese siperfaqeje trualli) |
| 14 | 315/539-ND, 315/539/1 | 250.00 | Truall | 196.40 | 4,242.00 | 833,128.80 | 139.80 | 53,500.00 | 7,479,300.00 | 264.60 | 4,609,630.00 | 12,922,058.80 | |
| | | | | | | | | | | | | 167,159,240.06 | |

# LISTA EMËRORE E PRONARËVE TË PASURIVE, PRONË PRIVATE, PASURITË E PALUAJSTHME TË TË CILËVE, SHTOHEN NË VENDIMIN NR. 231, DATË 17.4.2019 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT "REHABILITIMI I SEGMENTIT RRUGOR "PALLATI ME SHIGJETA – RRETHRROTULLIMI "SHQIPONJA", I NDRYSHUAR

Tabela B, që pasqyron shtesat e bëra në tabelën bashkëlidhur VKM nr. 231, datë 17.4.2019, i ndryshuar

| NR | | | | | Të dhënat për pasuritë e shtuara | | | | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | | TOKË TRUALL | | | TOKË ARË | | | OBJEKT BANIMI | | | NDËRTESË SOC. EK | | | |
| | Emri | Atësia | Mbiemri | Zona Kadastrale | Numri Pasurisë | Sip. Totale m2 | Lloji Pasurise | Sipërfaqja e shpr.(m2) | Çmimi (lekë/m2) | Vlera lekë | Sip. e shpr.(m2) | Çmimi (lekë/m2) | Vlera lekë | Sipërfaqja e shpr.(m2) | Çmimi (lekë/m2) | Vlera lekë | Sipërfaqja e shpr.(m2) | Vlera e preventivit | VLERA Totale (LEKË) | Shënime |
| 1 | Bashkepronaret Shijaku, Brahja, Hallulli .. | | | 8210 | 7/260 | 3,618.77 | Truall | 3,618.77 | 38,614 | 139,735,184.78 | | | | | | | | | **139,735,184.78** | Konfirmuar nga ASHK |
| 2 | Aferdita | Ramadan | Ahmetaj | 3866 | 301/217-ND1 | 87.80 | Ndertese | | | | | | | 87.80 | 53,500.00 | 4,697,300.00 | | | **4,697,300.00** | Konfirmuar nga ASHK |
| 3 | Sami | Allaman | Asllanaj | 3866 | 301/217-ND3 | 124.30 | Ndertese | | | | | | | 86.80 | 53,500.00 | 4,643,800.00 | 37.50 | 968,488.00 | **5,612,288.00** | Konfirmuar nga ASHK |
| 4 | Perparim | Gani | Brahimaj | 3866 | 301/217-ND | 84.30 | Ndertese | | | | | | | 83.40 | 53,500.00 | 4,461,900.00 | | | **4,461,900.00** | Konfirmuar nga ASHK |
| 5 | Vjollca | | Nenada | 3866 | 305/287 | 275.60 | Truall ndertese | 99.60 | 4,242 | 422,503.20 | | | | 150.40 | 53,500.00 | 8,046,400.00 | 45.90 | 1,625,787.80 | **10,094,691.00** | Konfirmuar nga ASHK |
| 6 | Gazmir | Nuri | Hoxhaj | 3866 | 215/202 | 344.80 | Truall Ndertese | 66.30 | 4,242 | 281,244.60 | | | | | | | 1,632.00 | 30,530,736.35 | **30,811,980.95** | Konfirmuar nga ASHK |
| 7 | Haxhi | Rexhep | Brahimaj | 3866 | 305/285 | 281.80 | Truall ndertese | 96.70 | 4,242 | 410,201.40 | | | | 140.30 | 53,500.00 | 7,506,050.00 | 97.50 | 3,245,440.27 | **11,161,691.67** | Konfirmuar nga ASHK |
| 8 | Aishe<br>Fahrije<br>Lule<br>Nexhmije<br>Romina<br>Matilda<br>Demir<br>Qanie | Demir<br>Hamdi<br>-<br>Ruzhdi<br>Ruzhdi<br>Ruzhdi<br>Ruzhdi<br>Ruzhdi | Avdillari<br>Avdillari<br>Avdillari<br>Avdillari<br>Avdillari<br>Avdillari<br>Avdillari<br>Avdillari | 3866 | 315/188 | 505.00 | are | | | | 111.00 | 448.00 | 49,728.00 | | | | | | **49,728.00** | Konfirmuar nga ASHK |
| 9 | Aishe<br>Fahrije<br>Lule<br>Nexhmije<br>Romina<br>Matilda<br>Demir<br>Qanie | Demir<br>Hamdi<br>-<br>Ruzhdi<br>Ruzhdi<br>Ruzhdi<br>Ruzhdi<br>Ruzhdi | Avdillari<br>Avdillari<br>Avdillari<br>Avdillari<br>Avdillari<br>Avdillari<br>Avdillari<br>Avdillari | 3866 | 315/184 | 300.00 | are | | | | 155.60 | 448.00 | 69,708.80 | | | | | | **69,708.80** | Konfirmuar nga ASHK |
| 10 | Aishe<br>Fahrije<br>Lule<br>Nexhmije<br>Romina<br>Matilda<br>Demir<br>Qanie | Demir<br>Hamdi<br>-<br>Ruzhdi<br>Ruzhdi<br>Ruzhdi<br>Ruzhdi<br>Ruzhdi | Avdillari<br>Avdillari<br>Avdillari<br>Avdillari<br>Avdillari<br>Avdillari<br>Avdillari<br>Avdillari | 3866 | 315/186 | 150.00 | are | | | | 97.00 | 448.00 | 43,456.00 | | | | | | **43,456.00** | Konfirmuar nga ASHK |
| 11 | Aishe<br>Fahrije<br>Lule<br>Nexhmije<br>Romina<br>Matilda<br>Demir<br>Qanie | Demir<br>Hamdi<br>-<br>Ruzhdi<br>Ruzhdi<br>Ruzhdi<br>Ruzhdi<br>Ruzhdi | Avdillari<br>Avdillari<br>Avdillari<br>Avdillari<br>Avdillari<br>Avdillari<br>Avdillari<br>Avdillari | 3866 | 315/187 | 300.00 | are | | | | 140.00 | 448.00 | 62,720.00 | | | | | | **62,720.00** | Konfirmuar nga ASHK |
| 12 | Aqif | Rasim | Çuni | 2679 | 440/340 | 2,105.00 | are | | | | 793.70 | 448.00 | 355,577.60 | | | | | | **355,577.60** | Konfirmuar nga ASHK |
| 13 | Selim | | Ahmeti | 3866 | 315/203 | 707.00 | are | | | | 690.00 | 448.00 | 309,120.00 | | | | | | **309,120.00** | Konfirmuar nga ASHK |
| | | | | | | | | | | | | | | | | | | | **207,465,346.80** | |

**VENDIM**
**Nr.1100, datë 16.12.2020**

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.651, DATË 13.8.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE, TË DOKUMENTACIONIT DHE TË MASËS SË PËRFITIMIT TË NDIHMËS FINANCIARE, SI PASOJË E COVID-19, PËR TË PUNËSUARIT APO ISH-TË PUNËSUARIT NË SUBJEKTET E TRANSPORTIT PUBLIK, QYTETAS DHE NDËRQYTETAS"**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.88/2019, "Për buxhetin e vitit 2020", të ndryshuar, dhe të pikës 5, të nenit 41, të ligjit nr.45/2019, "Për mbrojtjen civile", me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave,

VENDOSI:

I. Në vendimin nr.651, datë 13.8.2020, të Këshillit të Ministrave, bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

Në kreun I bëhen këto shtesa:

a) Pas pikës 1 shtohet pika 1/1, më këtë përmbajtje:

"1/1. Dhënie ndihme financiare prej 10 000 lekësh për të punësuarit apo ish-të punësuarit në subjektet e transportit publik, qytetas, ndërqytetas si dhe aktivitetin taksi.".

b) Pas pikës 2 shtohen pikat 2/2 dhe 2/3, më këtë përmbajtje:

"2/2. E përfitojnë ndihmën financiare sipas pikës 1/1, të këtij kreu, të punësuarit apo ish-të punësuarit në subjektet sipas kësaj pike, të cilët kanë përfituar nga paketat e mëparshme të ndihmës financiare apo ky vendim, si edhe ata të cilët nuk kanë përfituar nga paketat e mëparshme të ndihmës financiare apo ky vendim, me kushtin që të figurojnë në listëpagesat e muajit shtator 2020.

2/3. Përjashtohen nga përfitimi i ndihmës financiare:

a) individët e punësuar, të cilët kanë realizuar për vitin 2019 të ardhura bruto nga paga mbi 2 000 000 (dy milionë) lekë;

b) punonjësit e institucioneve shtetërore;

c) të punësuarit në shoqëritë me kapital shtetëror".

2. Në kreun II bëhen ndryshimet dhe shtesa e mëposhtme:

a) Pika 1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"1. Ndihma financiare llogaritet dhe jepet për të punësuarit apo ish-të punësuarit në subjektet e transportit publik, qytetas, ndërqytetas, që figurojnë në listëpagesat e deklaruara për periudhën tatimore shkurt 2020, të cilat janë dorëzuar pranë administratës tatimore deri në datën 12.8.2020.".

b) Pas pikës 1 shtohen pikat 1/1 dhe 1/2, me këtë përmbajtje:

"1/1. Ndihma financiare, sipas pikës 1/1, të kreut I, llogaritet dhe jepet për të punësuarit apo ish-të punësuarit në subjektet e transportit publik, qytetas, ndërqytetas si dhe aktivitetin taksi, të cilët kanë përfituar nga paketat e mëparshme të ndihmës financiare apo ky vendim.

1/2. Për të punësuarit apo ish-të punësuarit në subjektet e transportit publik, qytetas, ndërqytetas si dhe aktivitetin taksi, të cilët nuk kanë përfituar nga paketat e mëparshme të ndihmës financiare apo ky vendim, ndihma financiare llogaritet dhe jepet për punonjësit apo ish-punonjësit që figurojnë në listëpagesat e muajit shtator 2020.".

c) Pika 3 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"3. Aplikimi për të përfituar ndihmën financiare për punonjësit apo ish-punonjësit, të cilët nuk kanë përfituar ndihmë financiare, sipas vendimeve të Këshillit të Ministrave nr.254, datë 27.3.2020, ose nr.305, datë 16.4.2020, bëhet nga vetë individët. Miratimi kryhet pas verifikimit të kritereve, bazuar në të dhënat që administrata tatimore disponon apo të dhënat që do të dorëzojnë.".

3. Pika 1, e kreut V, ndryshohet, si më poshtë vijon:

"1. Efektet financiare, në masën 245 886 000 (dyqind e dyzet e pesë milionë e tetëqind e tetëdhjetë e gjashtë mijë) lekë, do të përballohen nga fondi i rezervave të krijuara në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor.".

II. Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
**Erion Braçe**

**VENDIM**
**Nr. 1104, datë 24.12.2020**

**PËR MBULIMIN E SHPENZIMEVE TË MJEKIMIT TË Z. DRINI DOBI**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të ligjit nr. 88/2019, "Për buxhetin e vitit 2020", të ndryshuar, dhe në vijim të vendimit nr. 42, datë 22.1.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për financimin e shërbimeve shëndetësore spitalore nga skema e detyrueshme e sigurimeve të kujdesit shëndetësor, për vitin 2020", të ndryshuar; me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Mbulimin e shpenzimeve të mjekimit të z. Drini Dobi, në masën 3 500 000 (tre milionë e pesëqind mijë) lekë.
2. Ky fond të përballohet nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.
3. Pagesa të bëhet me paraqitjen e faturave përkatëse të institucionit të kurimit.
4. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
**Erion Braçe**

**VENDIM**
**Nr. 1105, datë 24.12.2020**

**PËR MBULIMIN E SHPENZIMEVE TË MJEKIMIT TË Z. MIHAL KËRÇI**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të ligjit nr. 88/2019, "Për buxhetin e vitit 2020", të ndryshuar, dhe në vijim të vendimit nr. 42, datë 22.1.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për financimin e shërbimeve shëndetësore spitalore nga skema e detyrueshme e sigurimeve të kujdesit shëndetësor, për vitin 2020", të ndryshuar; me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Mbulimin e shpenzimeve të mjekimit të z. Mihal Kërçi, në masën 1 000 000 (një milion) lekë.
2. Ky fond të përballohet nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.
3. Pagesa të bëhet me paraqitjen e faturave përkatëse të institucionit të kurimit.
4. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
**Erion Braçe**

**VENDIM**
**Nr. 139, datë 27.11.2020**

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KOMISIONIT KOMBËTAR RREGULLATOR NR. 3, DATË 3.2.2017, "PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË UJËSJELLËS-KANALIZIME PATOS SHA"**

Në mbështetje të nenit 13, 14, 15, 16 dhe 17, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", të ndryshuar, (ligji nr. 8102); të VKM-së nr. 958, datë 6.5.2009, "Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licencë" (VKM-ja nr. 958), si dhe të vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 29, datë 8.12.2009, "Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", të ndryshuar, (Rregullore e licencimit)

**Komisioni Kombëtar Rregullator,**

në mbledhjen e datës 27.11.2020, pasi shqyrtoi çështjen me objekt: "Mbi miratimin e projektvendimit, për një ndryshim në vendimin e Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 3, datë 3.2.2017, "Për licencimin e shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Patos sh.a.",

VËREN SE:

1. Shoqëria Ujësjellës-Kanalizime Patos (UK Patos) me shkresat nr. 189 prot., datë 5.11.2020, me lëndë "Kërkesë për ndryshim të zonës së shërbimit UK Patos", ka paraqitur pranë Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU), për ndryshim të zonës së shërbimit, dokumentacionin e nevojshëm mbi shkëputjen e njësive administrative Portëz dhe Cakran, të Bashkisë Fier, që më parë shërbeheshin nga UK Patos.

2. Komisioni Kombëtar Rregullator (KKRR) e gjeti paraqitjen e kërkesës për licencim, për shkak të ndryshimit të zonës së shërbimit të UK Patos, në konformitet me kriteret dhe procedurën e parashikuar në VKM-në nr. 958 dhe Rregulloren e licencimit.

3. KKRR-ja ka licencuar shoqërinë UK Patos me vendimin nr. 3, datë 3.2.2017, "Për licencimin e shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Patos sh.a." me një afat 4-vjeçar, ku shoqëria autorizohet të ofrojë shërbimin e grumbullimit dhe shpërndarjes së ujit për konsum publik, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura dhe për zonën e shërbimit, si më poshtë:

Bashkia:Patos

Bashkia:Fier, Njësia administrative Portëz, Cakran

Për gjithë sa më sipër, Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi arriti në përfundimin se kërkesa e UK Patos është e bazuar ligjërisht dhe plotëson kërkesat ligjore të parashikuara në kuadrin rregullator në fuqi,

VENDOSI:

Në pikën 3, të vendimit të KKRR-së nr. 3, datë 3.2.2017, "Për licencimin e shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Patos sh.a.", bëhen këto ndryshime:

Zona e shërbimit të shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Patos sh.a është Bashkia Patos.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR

**Ndriçim Shani**

**VENDIM**
**Nr. 140, datë 27.11.2020**

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 10, DATË 21.3.2017, "PËR LICENCIMIN E SHA UJËSJELLËS-KANALIZIME VLORË"**

Në mbështetje të nenit 13, 14, 16 dhe 17, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", të ndryshuar (ligji nr. 8102); të VKM-së nr. 958, datë 6.5.2009, "Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licencë" (VKM-ja nr. 958), si dhe të vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 29, datë 8.12.2009, "Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", të ndryshuar, (Rregullore e licencimit)

**Komisioni Kombëtar Rregullator,**

në mbledhjen e datës 27.11.2020, pasi shqyrtoi çështjen me objekt: "Mbi miratimin e projektvendimit 'Për një ndryshim në vendimin e Komisionit Kombëtar nr. 10, datë 21.3.2017, 'Për licencimin e sh.a. Ujësjellës-Kanalizime Vlorë''",

VËREN SE:

1. Shoqëria Ujësjellës-Kanalizime Vlorë (UK Vlorë), me shkresën nr. 235 prot., ERRU, datë 5.11.2020, me lëndë "Dërgim dokumentacioni për ndryshimin e drejtuesit ligjor të sh.a. Ujësjellës-Kanalizime Vlorë", ka paraqitur pranë Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU) kërkesën për rinovim të licencës, për efekt të ndryshimit të drejtuesit ligjor, të shoqëruar me dokumentacionin sipas përcaktimeve të parashikuara në VKM-në nr. 958 dhe Rregulloren e licencimit.

2. Komisioni Kombëtar Rregullator (KKRR) e gjeti paraqitjen e kërkesës së UK Vlorë, për rinovim licence për efekt të ndryshimit të drejtuesit ligjor, në konformitet me kriteret dhe procedurën e parashikuar në VKM-në nr. 958 dhe Rregulloren e licencimit.

3. KKRR-ja ka licencuar shoqërinë UK Vlorë me vendimin nr. 10, datë 21.3.2017, "Për licencimin e sh.a. Ujësjellës-Kanalizime Vlorë", me një afat 4-vjeçar, ku shoqëria autorizohet të ofrojë shërbimin e grumbullimit dhe të shpërndarjes së ujit për konsum publik, si dhe të largimit të ujërave të ndotura.

4. Drejtuesi ligjor i shoqërisë UK Vlorë sh.a., z. Shkëlqim Leskaj, ka mbaruar studimet e larta në Ekonomi, dega Marketing në vitin 2007.

5. ERRU-ja, në vlerësimin e kërkesës për ndryshimin e licencës, për efekt të ndryshimit të drejtuesit ligjor, ka marrë në konsideratë përmbushjen nga ana e UK Vlorë sh.a. të kërkesave të ligjit nr. 8102, të VKM-së nr. 958 dhe të Rregullores së licencimit, në mënyrë të veçantë sa i takon garantimit që i licencuari të veprojë në përputhje me kushtet e licencës së tij dhe të mbrojë interesat e konsumatorëve në lidhje me cilësinë, eficiencën, vazhdueshmërinë dhe garancinë e shërbimit.

Për gjithë sa më sipër, Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi arriti në përfundimin se aplikimi i UK Vlorë është i bazuar ligjërisht dhe plotëson kërkesat ligjore të parashikuara në kuadrin rregullator në fuqi,

VENDOSI:

Në pikën 1, të vendimit të KKRR-së nr. 10, datë 21.3.2017, "Për licencimin e sh.a. Ujësjellës-Kanalizime Vlorë" bëhen këto ndryshime:

"Drejtues Ligjor: Shkëlqim Leskaj"

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
**Ndriçim Shani**

**VENDIM**
**Nr. 141, datë 27.11.2020**

## PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KOMISIONIT KOMBËTAR RREGULLATOR NR. 41, DATË 1.6.2018, "PËR LICENCIMIN E SHA UJËSJELLËS-KANALIZIME FINIQ"

Në mbështetje të nenit 13, 14, 16 dhe 17, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", të ndryshuar, (ligji nr. 8102), të VKM-së nr. 958, datë 6.5.2009, "Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licencë" (VKM-ja nr. 958), si dhe të vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 29, datë 8.12.2009, "Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", të ndryshuar (Rregullore e licencimit),

**Komisioni Kombëtar Rregullator,**

në mbledhjen e datës 27.11.2020, pasi shqyrtoi çështjen me objekt: "Mbi miratimin e projektvendimit 'Për një ndryshim në vendimin e Komisionit Kombëtar nr. 41, datë 1.6.2018, 'Për licencimin e sh.a. Ujësjellës-Kanalizime Finiq'''

VËREN SE:

1. Shoqëria Ujësjellës-Kanalizime Finiq (UK Finiq), me shkresën nr. 105 prot., datë 10.11.2020, me lëndë "Dërgim dokumentacioni", ka paraqitur pranë Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU) kërkesën për rinovim të licencës, për efekt të ndryshimit të drejtuesit ligjor, të shoqëruar me dokumentacionin sipas përcaktimeve të parashikuara në VKM-në nr. 958 dhe në Rregulloren e licencimit.

2. Komisioni Kombëtar Rregullator (KKRR) e gjeti paraqitjen e kërkesës së UK Finiq, për rinovim licence për efekt të ndryshimit të drejtuesit ligjor, në konformitet me kriteret dhe procedurën e parashikuar në VKM-në nr. 958 dhe në Rregulloren e licencimit.

3. KKRR-ja ka licencuar shoqërinë UK Finiq me vendimin nr. 41, datë 1.6.2018, "Për licencimin e sh.a. Ujësjellës-Kanalizime Finiq, me një afat 4-vjeçar, ku shoqëria autorizohet të ofrojë shërbimin e grumbullimit dhe të shpërndarjes së ujit për konsum publik, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura.

4. Drejtuesi ligjor i shoqërisë UK Finiq sh.a., z. Mihal Çavo, ka mbaruar studimet e larta në Fakultetin e Inxhinierisë, në degën Hidroteknikë.

5. ERRU-ja, në vlerësimin e kërkesës për ndryshimin e licencës për efekt të ndryshimit të drejtuesit ligjor, ka marrë në konsideratë përmbushjen nga ana e UK Finiq sh.a. të kërkesave të ligjit nr. 8102, të të VKM-së nr. 958 dhe të Rregullores së licencimit, në mënyrë të veçantë sa i takon garantimit që i licencuari të veprojë në përputhje me kushtet e licencës së tij dhe të mbrojë interesat e konsumatorëve në lidhje me cilësinë, eficiencën, vazhdueshmërinë dhe garancinë e shërbimit.

Për gjithë sa më sipër, Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi arriti në përfundimin se aplikimi i UK Finiq është i bazuar ligjërisht dhe plotëson kërkesat ligjore të parashikuara në kuadrin rregullator në fuqi,

VENDOSI:

1. Në pikën 1, të vendimit të KKRR-së nr. 41, datë 1.6.2018, "Për licencimin e sh.a. Ujësjellës-Kanalizime Finiq" bëhen këto ndryshime:

"Drejtues Ligjor: z. Mihal Çavo"

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
**Ndriçim Shani**

## VENDIM
## Nr. 142, datë 27.11.2020

## PËR MIRATIMIN E TARIFAVE TË SHËRBIMIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE LARGIMIN E UJËRAVE TË NDOTURA PËR SHOQËRINË UJËSJELLËS-KANALIZIME FIER SHA

Në mbështetje të nenit 13, 14, 21 dhe 22, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", të ndryshuar, (ligji nr. 8102); të vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 39, datë 9.12.2015, "Për miratimin e politikës tarifore për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura" (vendimi nr. 39); të vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 40, datë 9.12.2015, "Për miratimin e dokumentacionit mbështetës për miratimin e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë, largimin e përpunimin e ujërave të ndotura" (vendimi nr. 40); të vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 41, datë 9.12.2015, "Për miratimin e procesit të miratimit të tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë, largimin e përpunimin e ujërave të ndotura" (vendimi nr. 41); të vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 42, datë 9.12.2015, "Për miratimin e metodologjisë për vendosjen e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimin e përpunimin e ujërave të ndotura" (vendimi nr. 42),

**Komisioni Kombëtar Rregullator,**

në mbledhjen e datës 27.11.2020, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga Drejtoria Tekniko-Ekonomike, mbi kërkesën e Ujësjellës-Kanalizime Fier sh.a. për miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe kanalizime,

VËREN SE:

Shoqëria "Ujësjellës-Kanalizime Fier" (UK Fier) me shkresë nr. 136 prot., datë 18.2.2020, me lëndë "Kërkesë për unifikim tarife për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimin (kanalizimin) e ujërave të ndotura", ka paraqitur kërkesën, pranë Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura

(ERRU), për ndryshimin e tarifave në zonën e shërbimit për të tri kategoritë e konsumatorëve, të shoqëruar me dokumentacionin sipas përcaktimeve të parashikuara në ligjin nr. 8102 dhe në vendimin nr. 40.

1. Komisioni Kombëtar Rregullator (KKRR), pasi e gjeti paraqitjen e kërkesës për vendosjen e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimin e ujërave të ndotura dhe tarifën fikse të shoqërisë UK Fier në përputhje me përcaktimet dhe procedurën e parashikuar në vendimin nr. 40, me vendimin nr. 90, datë 28.7.2020, vendosi fillimin e procedurës, për shqyrtimin e aplikimit për propozimin e bërë nga UK Fier, për unifikimin tarifor për shërbimet UK për të gjithë zonën e riorganizuar të shërbimit, në zbatim të VKM-së nr. 63, datë 27.1.2016, "Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura".

2. Ujësjellës-Kanalizime Fier, në dokumentacionin e paraqitur pranë ERRU-së me shkresë nr. 136 prot., datë 18.2.2020, "Kërkesë për unifikim tarifash për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimin (kanalizime) e ujërave të ndotura", propozon ndryshim të nivelit tarifor për të tri kategoritë e konsumatorëve, sipas tabelës së mëposhtme:

**Tabela me tarifat aktuale dhe të propozuara nga shoqëria sipas kategorisë së konsumatorëve**

| Kategoria e klientëve | Tarifat aktuale | | | | | | | Tarifat e propozuara |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Frakull | Fier, Topojë, Qendër | Cakran | Dermenas | Mbrostar | Portëz, Levan | Libofsh | E gjithë zona e shërbimit |
| A. Tarifë volumetrike për furnizimin me ujë | lek/m³ | lek/m³ | lek/m³ | lek/m³ | lek/m³ | lek/m³ | lek/m³ | lek/m³ |
| 1. Klientë familjarë | 45 | 52 | 50 | 42 | 50 | 45 | 40 | 52 |
| 2. Klientë publikë | 105 | 105 | 105 | 105 | 105 | 105 | 105 | 105 |
| 3. Klientë privatë | 125 | 125 | 50 | 125 | 60 | 125 | 70 | 125 |
| 4. Klientë të veçantë* (Industri) | - | 70 | - | - | - | - | - | - |
| B. Tarifë volumetrike për shërbimin e kanalizimeve | lek/m³ | lek/m³ | lek/m³ | lek/m³ | lek/m³ | lek/m³ | lek/m³ | lek/m³ |
| 1. Klientë familjarë | 13 | 13 | - | 13 | - | - | - | 13 |
| 2. Klientë publikë | 18 | 18 | 18 | 18 | 18 | 18 | 18 | 18 |
| 3. Klientë privatë | 20 | 20 | - | 0 | - | - | - | 20 |
| 4. Klientë të veçantë* (Industri) | - | 20 | - | - | - | - | - | - |
| C. Tarifë fikse shërbimi | lek/muaj /lidhje | lek/muaj /lidhje | lek/muaj /lidhje | lek/muaj /lidhje | lek/muaj /lidhje | lek/muaj /lidhje | lek/muaj /lidhje | lek/muaj /lidhje |
| 1. Klientë familjarë | 200 | 200 | - | - | - | - | - | 200 |
| 2. Klientë publikë | 200 | 200 | - | - | - | - | - | 200 |
| 3. Klientë privatë | 200 | 200 | - | - | - | - | - | 200 |
| D. Tarifë shitje uji me shumicë, komuna Portëz (fshati Plyk) 26 lek/m³** | | | | | | | | - |

**Te kategoria 'klientë të veçantë' janë TEC Fier dhe Uzina e përpunimit të naftës të cilët janë trajtuar me tarifa të ndryshme nga kategoria klientë privat, sipas vendimit nr. 9 datë 21.4.2014. Prej 4 vitesh këto dy biznese kanë gjetur burime alternative për furnizimin me ujë dhe shoqëria UK Fier nuk u ofron shërbim.*

***Tarifë shitje uji me shumicë nuk do të aplikohet më duke qenë se këtë fshat e administron vetë UK Fier që nga riorganizimi.*

3. Në aplikimin aktual, duke marrë si referencë vitin e mbyllur 2019, për të cilin shoqëria ka aplikuar tarifat për secilën zonë të shërbimit, referuar tarifave të reja të propozuara, shoqëria ka përcaktuar edhe objektivat që do realizohen në vitin e ardhshëm. Treguesit kryesorë të performancës para riorganizimit dhe objektivat për vitin 2019 dhe vitin 2020 jepen në tabelën e mëposhtme.

**Treguesit kryesorë të performancës sipas shoqërisë, për vitet 2019–2020**

| Treguesit e performancës | Njësia e matjes | Treguesit e performancës sipas shoqërisë | | |
|---|---|---|---|---|
| | | Para riorganizimit | Viti 2019 | Viti 2020 |
| 1. Mbulimi i kostove O&M | % | 121 | 90 | 91 |
| 2. Mbulimi i kostove totale | % | 93 | 75 | 76 |
| 3. Uji pa të ardhura | % | 61.3 | 72.3 | 72 |
| 4. Mbulimi me ujë | % | 92 | 63.2 | 65 |
| 5. Mbulimi me KUN | % | 62 | 48 | 48 |
| 6. Niveli i matjes | % | 55 | 65 | 65 |
| 7. Norma e arkëtimit korrente | % | 76 | 83 | 84 |
| 8. Vazhdimësia e FU-së | orë/ditë | 20.26 | 20 | 20 |
| 9. Eficienca e stafit UK | staf/1000 lidhje UK | 6.37 | 6.26 | 6.26 |

4. Shoqëria në relacionin e saj e justifikon nevojën e ndryshimit të tarifave sipas argumenteve të mëposhtme:

a) për arsye të riorganizimit, në zbatim të VKM-së nr. 63, datë 27.1.2016, "Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura";

b) aplikon për nivel të ri tarifor vetëm për zonat e shtuara në kuadër të riorganizimit;

c) aplikon për të njëjtin nivel tarifor që ka zona ekzistuese duke siguruar unifikimin e tarifave për të gjithë zonën e shërbimi;

d) nevoja për përballimin e kostove të shtuara si rezultat i zgjerimit të zonës së shërbimit.

Pas ndarjes së re administrative disa nga treguesit e performancës, si: mbulimi i kostove O&M dhe i kostove totale, kanë pësuar rënie krahasuar me periudhën e para riorganizimit. Po kështu edhe treguesit teknik si uji pa të ardhura apo mbulimi me shërbimin e FU dhe KUN janë përkeqësuar dhe kanë dhënë efektet në financat e shoqërisë. Përmirësimi i tyre kërkon ndërhyrjen me investime për zgjerimin e zonës së shërbimit. Përfshirja në skemën e shërbimit të klientëve të rinj do të sjellë rritje të nivelit të faturimit e më pas rritje të të ardhurave të shoqërisë.

UK Fier synon vetëm unifikimin e tarifave për të gjithë zonën e shërbimit, duke propozuar tarifat që kanë zonat ekzistuese, me të cilat duke ruajtur të njëjtin nivel kostosh arrin të ketë pothuaj të njëjtën situatë financiare, me një rritje prej 3% të mbulimit të kostove O&M.

5. Gjatë procesit të analizës teknike ekonomike, sipas metodologjisë së llogaritjes së tarifave të përcaktuar në vendimin nr. 42, ERRU-ja ka kërkuar informacion shtesë nga UK Fier, si dhe verifikim të saktësisë së të dhënave të vëna në dispozicion nga shoqëria.

6. ERRU-ja, në vlerësimin e tarifave të propozuara dhe të treguesve të performancës, si dhe në analizën ekonomike, financiare, ka marrë në konsideratë përmbushjen nga ana e UK Fier të kritereve të mëposhtme:

a) kërkesave të ligjit nr. 8102, si dhe të akteve nënligjore dhe kuadrit rregullator në fuqi, në mënyrë të veçantë mbrojtjen e konsumatorëve nga çmimet monopol;

b) kërkesave të ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003, "Për mbrojtjen e konkurrencës", të ndryshuar, (ligji nr. 9121), për mos lejimin e abuzimit me pozitën dominuese në treg të ndërmarrjes nëpërmjet vendosjes, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, të çmimeve të padrejta të shitjes apo të kushteve të tjera të tregtimit;

c) kërkesave të ligjit nr. 9902, datë 17.4.2008, "Për mbrojtjen e konsumatorëve", të ndryshuar, (ligji nr. 9902);

d) orientimin drejt mbulimit të kostove të Operim & Mirëmbajtjes;

e) tarifat e propozuara nga operatori të jenë në përputhje të plotë me parimin ligjor rregullator mbi përballueshmërinë e tyre nga ana e konsumatorëve familjarë;

f) tarifat e propozuara nuk sjellin për pasojë efekte negative në mjedis nga veprimtaria e

operatorit në zonën e shërbimit që ato do të aplikohen;

g) propozimin për ndryshimin e tarifave nga shoqëria ERRU-ja e gjen të justifikuar në nivelin e propozuar nga shoqëria, referuar kjo analizës tekniko-ekonomike, si dhe realizimit të objektivave të performancës së përcaktuar.

7. ERRU-ja, në bazë të analizës, verifikimeve dhe komunikimit me stafin drejtues të shoqërisë i konsideron të arritshëm objektivat mbi treguesit e performancës dhe për këtë rekomandon:

a) shoqëria duhet të hartojë një plan biznesi (pesëvjeçar) duke marrë në konsideratë situatën aktuale të zonës së shërbimit pas riorganizimit, me objektiva dhe plane veprimi për realizimin e tyre;

b) me qëllim arritjen e mbulimit të kostove të operimit dhe të mirëmbajtjes, shoqëria duhet të përpiqet të reduktojë humbjet dhe të përmirësojë treguesit me të gjitha kapacitetet e saj, si dhe të evidentojë të gjithë klientët në zonën e shërbimit (kryesisht zona rurale e shtuar);

c) të mbajë kostot me qendra kostoje për secilin shërbim, me qëllim orientimin e tarifave drejt kostove respektive;

d) të bëjë përpjekje për t'u bërë pjesë e projekteve, me qëllim investimin në zonën e shtuar, për ofrimin e shërbimit cilësor dhe instalimin e matësve për të gjithë klientët;

e) të evidentojë në terren, kryesisht në zonën e shtuar klientët e rinj, me qëllim saktësimin maksimal të përfituesve të shërbimit;

f) të aplikojë për nivel të ri tarifor në vitin 2022, duke plotësuar dokumentacionin konform metodologjisë së vendosjes së tarifave, me synimin e mbulimit të kostove O&M mbi 100%, nëpërmjet përmirësimit të treguesve të punës, si dhe nëpërmjet nivelit të ri tarifor;

g) brenda vitit 2021 të përfundojë instalimi i matësve në të gjithë klientët jo familjar.

Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi vlerësoi tarifat e propozuara nga operatori, mbi bazën e metodologjisë së miratuar me vendimin nr. 42, datë 9.12.2015, "Për miratimin e metodologjisë për vendosjen e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largim e përpunimin e ujërave të ndotura", si dhe akteve të tjera rregullatore që lidhen me të, arrin në konkluzionin se tarifat e propozuara sipas analizës së kryer janë të bazuara dhe në zbatim të kritereve ligjore referuese, lidhur me kostot e pranueshme dhe të justifikuara, si dhe përballueshmërinë, nuk janë të padrejta dhe të vendosura në kushtet e abuzimit me pozitën dominuese në treg të operatorit ekonomik, në kuptim të ligjit nr. 9121, "Për mbrojtjen e konkurrencës", të ndryshuar, dhe ligjin nr. 9902, "Për mbrojtjen e konsumatorëve"; për gjithë sa më sipër, në zbatim të nenit 13, 14 dhe 22, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", të ndryshuar,

VENDOSI:

1. Miratimin e tarifave për shoqërinë Ujësjellës-Kanalizime Fier, si më poshtë:

| Kategoria | Tarifat sipas vendimit në zonën e shërbimit |
|---|---|
| Tarifë volumetrike për furnizimin me ujë | lek/m$^3$ |
| Konsumatorë familjarë | 52 |
| Konsumatorë publikë | 105 |
| Konsumatorë privatë | 125 |
| Tarifë volumetrike për KUN* | lek/m$^3$ |
| Konsumatorë familjarë | 13 |
| Konsumatorë publikë | 18 |
| Konsumatorë privatë | 20 |
| Tarifë fikse | lek/muaj/lidhje |
| Konsumatorë familjarë | 200 |
| Konsumatorë publik | 200 |
| Konsumatorë privat | 200 |

* Tarifat e KUN do të zbatohen vetëm në ato pjesë të zonës së shërbimit ku ofrohet ky shërbim.

2. Objektivat e treguesve kryesorë të performancës, për vitin 2021, për UK Fier, do të jenë:

| Treguesit e performancës | Njësia e matjes | Niveli i objektivit për vitin 2021 të përcaktuar nga ERRU-ja |
|---|---|---|
| Mbulimi i kostove O&M | % | 94 |
| Mbulimi i kostove totale | % | 79 |
| Uji pa të ardhura | % | 69 |
| Mbulimi me ujë | % | 66 |
| Mbulimi me KUN | % | 48 |
| Niveli i matjes | % | 70 |
| Norma e arkëtimit korrente | % | 85 |
| Vazhdimësia e furnizimit me ujë | Orë/ditë | 21 |
| Eficienca e stafit | Staf/1000 lidhje | 6.26 |

3. Pagesa rregullatore vjetore për shoqërinë Ujësjellës-Kanalizime Fier sh.a. do të jetë 0.6% e të ardhurave vjetore të parashikuara nga aktiviteti.

4. Lidhjen e kontratës me UK Fier, brenda 30 ditëve nga data e njoftimit, sipas pikës 4, të nenit 22, të ligjit nr. 8102.

5. Vendimi nr. 9, datë 21.4.2014, "Për miratimin e tarifave të ujit për konsum publik për shoqërinë UK Fier sh.a." shfuqizohet.

6. Ky vendim hyn në fuqi më datë 1.1.2021 dhe është i vlefshëm deri në miratimin e tarifave të reja.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
**Ndriçim Shani**

**VENDIM**
**Nr. 143, datë 27.11.2020**

**PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË UJËSJELLËS-KANALIZIME URA VAJGURORE SHA**

Në mbështetje të nenit 13, 14, 15, 16 dhe 17, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", të ndryshuar, (ligji nr. 8102), të VKM-së nr. 958, datë 6.5.2009, "Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licencë" (VKM-ja nr. 958), si dhe të vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 29, datë 8.12.2009, "Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", të ndryshuar, (Rregullore e licencimit),

**Komisioni Kombëtar Rregullator,**

në mbledhjen e datës 27.11.2020, pasi shqyrtoi çështjen me objekt: "Mbi miratimin e projektvendimit 'Për licencimin e shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Ura Vajgurore sh.a.'",

VËREN SE:

1. Shoqëria Ujësjellës-Kanalizime Ura Vajgurore (UK Ura Vajgurore), me shkresën nr. 64 prot., datë 28.9.2020, si dhe plotësimet me shkresat përcjellëse nr. 77 prot., datë 26.10.2020, dhe nr. 81 prot., datë 9.11.2020, ka paraqitur pranë Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU) kërkesën për rinovim licence për shkak të mbarimit të afatit.

2. Komisioni Kombëtar Rregullator (KKRR) e gjeti paraqitjen e kërkesës për licencim për shkak të mbarimit të afatit, të UK Ura Vajgurore, në konformitet me kriteret dhe procedurën e parashikuar në VKM-në nr. 958 dhe në Rregulloren e licencimit, si dhe në zbatim të parashikimeve të VKM-së nr. 63 datë 27.1.2016, "Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë

shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura" (VKM-ja nr. 63).

3. Referuar kërkesës dhe dokumentacionit shoqërues, rezulton se:

a) Shoqëria UK Ura Vajgurore ofron shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura për 16 560 banorë të Bashkisë Dimal (Ura Vajgurore);

b) Drejtuesja teknike e shoqërisë UK Ura Vajgurore, znj. Jolanda Gjordeni, është diplomuar në Universitetin Politeknik, në Fakultetin e Inxhinierisë së ndërtimit, dega Hidroteknikë në vitin 2013, plotëson kërkesat e VKM-së nr. 958 mbi edukimin dhe eksperiencën në profesion.

4. ERRU-ja, në vlerësimin e kërkesës për licencim për shkak të mbarimit të afatit ka marrë në konsideratë përmbushjen nga ana e UK Ura Vajgurore, të:

a) kërkesave të ligjit nr. 8102, si dhe të kuadrit rregullator në fuqi, në mënyrë të veçantë plotësimin e kushteve si aftësitë tekniko-profesionale, aftësitë financiare të nevojshme për të përmbushur funksionet dhe për të plotësuar kushtet e licencës, përvojën në sektorin e ujësjellësve dhe kanalizimeve të mjaftueshme për të marrë përsipër detyrimet që ka licenca, si dhe mbrojtjen e interesave të konsumatorëve në lidhje me cilësinë, eficiencën, vazhdueshmërinë dhe garancinë e shërbimit;

b) kërkesave të ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003, "Për mbrojtjen e konkurrencës", të ndryshuar, (ligji nr. 9121), për mos lejimin e abuzimit me pozitën dominuese në treg të ndërmarrjes, veçanërisht në lidhje me kufizimin e tregjeve.

Për gjithë sa më sipër, Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi arriti në përfundimin se kërkesa e UK Ura Vajgurore është e bazuar ligjërisht dhe plotëson kërkesat ligjore të parashikuara në kuadrin rregullator në fuqi,

VENDOSI:

1. Licencimin e shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Ura Vajgurore sh.a. me (NUIS: K32803022R), në kategoritë:

a) Kategoria A - Për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik;

b) Kategoria C - Për largimin e ujërave të ndotura.

2. Shoqëria Ujësjellës-Kanalizime Ura Vajgurore sh.a. autorizohet të kryejë veprimtaritë e licencuara me:

a) Drejtues Ligjor: Petref Sula;

b) Drejtuese Teknike: Jolanda Gjordeni.

3. Zona e shërbimit të shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Ura Vajgurore sh.a. është Bashkia Dimal (Ura Vajgurore).

4. Kjo licencë është e vlefshme për një periudhë 4-vjeçare.

5. Drejtuesi ligjor i shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Ura Vajgurore sh.a. detyrohet të nënshkruajë kushtet e licencës brenda 10 ditëve nga data e njoftimit.

6. Ngarkohet Drejtoria Tekniko-Ekonomike të njoftojë shoqërinë Ujësjellës-Kanalizime Ura Vajgurore sh.a. për marrjen e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
**Ndriçim Shani**

## VENDIM
(*i shkurtuar*)

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë me vendimin nr. 4340, datë 15.10.2020, vendosi konfirmimin e vdekjes së shtetases Edlira Kovaçi në datë 30.6.1995, si dhe caktimin e kujdestarit për administrimin e pasurisë së saj, shtetasin Luan Kovaçi.

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Vulosur elektronikisht nga Qendra e Botimeve Zyrtare
Viti: 2020 - Numri: 231
Datë: 2020/12/29 16:34:56
c6b39d06-c2d5-4eea-a89f-972d07c86854

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Qendra e Botimeve Zyrtare)*

| | |
|---|---|
| | Formati 61x86/8 |

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2020

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 144 lekë